



gent:

KARTA MJEKËSORE GENT PËR NDIHMË MJEKËSORE URGJENTE

Informacion për përdoruesit

AL

NL

**Keni nevojë për ndihmë mjekësore por nuk keni leje qëndrimi, as para?
Mbase keni të drejtë të merrni një kartë mjekësore.**

Ndihma mjekësore urgjente, çfarë është kjo?

Ata njerëz që nuk kanë një leje qëndrimi por që kanë nevojë urgjente për ndihmë, kanë të drejtë të marrin ndihmë mjekësore. Kjo mund të jetë ndihmë për të parandaluar një përkeqësim të gjendjes shëndetësore ose ndihmë për t'u shëruar.

Ju mund të ndihmoheni me:

- vizitë tek doktori
- ilaçe
- shtrim në spital
- shërbim infermieror në shtëpi
- analiza - laborator
- fizioterapi
- përkujdesje për dhëmbët, ...

Cilat janë kushtet?

- Ju nuk keni (akoma) një leje qëndrimi, ose e keni humbur të drejtën e qëndrimit në Belgjikë (përshembull azilkërkuesit të cilëve u ka mbaruar procedura).
- Ju banoni dhe qëndroni në Gent.
- Ju nuk keni të ardhura të mjaftueshme.

Si mund ta përdorni kartën mjekësore?

- Çdo herë që ju shkoni tek stafi mjekësor (doktori, dentisti,...) apo farmacisti, duhet t'u tregoni kartën mjekësore.
- Gjatë çdo vizite që bëni, ju duhet të nënshkruani një dokument për marrjen përsipër të kostos nga OCMW Gent. Stafi mjekësor e ka këtë dokument.

Kini kujdes: karta mjekësore është personale!

Heb je geen wettig verblijf en geen geld, maar wel nood aan dringende medische hulp? Misschien kun je een medische kaart krijgen.

Dringende medische hulp, wat is dat?

Mensen zonder wettig verblijf die dringend verzorging nodig hebben, hebben recht op medische hulp. Dit kan verzorging zijn om erger te voorkomen of om te genezen.

Je kunt hulp krijgen voor:

- doktersbezoek
- medicatie
- opname in een ziekenhuis
- thuisverpleging
- labo-onderzoek
- kinesitherapie
- verzorging van de tanden, ...

Wat zijn de voorwaarden?

- Je hebt (nog) geen verblijfsrecht of geen verblijfsrecht meer in België (bijvoorbeeld uitgeprocedeerde asielzoekers).
- Je woont en verblijft in Gent.
- Je hebt niet genoeg geld.

Hoe gebruik je de medische kaart?

- Elke keer dat je naar een zorgverlener (arts, tandarts, ...) of apotheek gaat, toon je de medische kaart.
- Bij elk bezoek onderteken je een document om de kosten te laten betalen door OCMW Gent. De zorgverlener heeft dit document.

Let op: de medische kaart is strikt persoonlijk!

AL

Si mund ta merrni kartën mjekësore?



1

Lini një takim me zyrën e OCMW Gent tek **Welzijnsonthaal Campus Prins Filip**. Ju do t'i gjeni të dhënat e kësaj zyre në fund të kësaj broshure. Merrni me vete këto gjëra:

- dokumentet tuaja të identifikimit
- një përmbledhje të të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja
- faturat tuaja mjekësore, nëse i keni

2

Një punonjës social shikon gjatë **bisedës së parë** me ju, nëse ju i plotësoni kushtet. Nëse është kështu, do merrni një ftesë për një takim të dytë.

3

Gjatë **bisedës së dytë** punonjësi social do të shqyrtojë situatën tuaj të qëndrimit, të banimit, atë financiare (të ardhurat dhe shpenzimet) dhe përbërjen e familjes. Mund edhe të bëhet një vizitë shtëpie.

4

Nëse çdo gjë shkon mirë gjatë procedurës së shqyrtimit të situatës tuaj, atëherë ju do të merrni kartën mjekësore. Ajo është e vlefshme për **maksimumi 3 muaj**. Në datën e skadencës të kartës tuaj mjekësore ju mund të shkoni tek punonjësi social për ta rinovuar.

Kujdes:

A jeni të regjistruar tek një mutualitet (sigurimet shëndetësore) në Belgjikë apo në Evropë? Atëherë kërkojini fillimisht mutualitet-it që t'ju rimbursojë për shpenzimet mjekësore. Me kartën mjekësore mund të rimburseheni vetëm për pjesën e pagesës që i takon pacientit.

NL

Hoe vraag je een medische kaart aan?



1

Maak een afspraak met het **Welzijnsonthaal Campus Prins Filip** van OCMW Gent. Je vindt de gegevens achteraan in deze brochure. Neem het volgende mee:

- je identiteitsdocumenten
- een overzicht van je inkomsten en uitgaven
- je medische facturen, als je die hebt

2

Een maatschappelijk werker bekijkt tijdens een **1ste gesprek** of je aan de voorwaarden voldoet. Is dat zo, dan krijg je een uitnodiging om een 2de keer langs te komen.

3

Tijdens een **2de gesprek** onderzoekt een maatschappelijk werker je verblijfs- en woonsituatie, je financiële situatie (inkomsten en uitgaven) en je gezinssamenstelling. Er volgt misschien een huisbezoek.

4

Is het onderzoek goed verlopen? Dan krijg je een medische kaart. Die is maximum **3 maanden geldig**. Op de vervaldag van je medische kaart ga je terug naar je maatschappelijk werker om de kaart te verlengen.

Let op:

Ben je aangesloten bij een ziekenfonds (Europees of Belgisch)? Vraag eerst aan het ziekenfonds om je medische kosten terug te betalen. Met de medische kaart kun je alleen terugbetaling krijgen van de oplegkosten.



Ne e referojmë këtë person për të kërkuar një kartë mjekësore tek:

Welzijnsonthaal Campus Prins Filip - Offerlaan 264 - 9000 Gent

Personi duhet të lerë **vetë** një takim në numrin e telefonit **09 266 99 11**.
Ky numër është i disponueshëm nga e hëna deri të premten nga ora 08:30 deri në 12:30 dhe nga ora 13:30 deri në orën 17:00.

Ne kemi lënë një takim për këtë person në:
.....(data dhe ora)

Emri

Mbiemri

Ditëlindja

Nënshtetësia

Adresa e qëndrimit

Telefoni

We verwijzen deze persoon door voor de aanvraag van een medische kaart in:

Welzijnsonthaal Campus Prins Filip - Offerlaan 264 - 9000 Gent

De persoon maakt **zelf** een afspraak op tel. **09 266 99 11**.
Bereikbaar van maandag tot en met vrijdag van 8.30 tot 12.30 uur en van 13.30 tot 17 uur.

Wij maakten een afspraak voor deze persoon op
.....(datum en uur)

Voornaam

Achternaam

Geboortedatum

Nationaliteit

Verblijfsadres

Telefoon

INFORMACION

Dienst Gezondheidszorg & Medische Kaart
(Shërbimi i kujdesit ndaj shëndetit & Karta mjekësore)
Adresa e vizitave: Offerlaan 264, 9000 Gent
Adresa për postën: Botermarkt 1, 9000 Gent
☎ 09 266 99 11
✉ onthaal.gezondheidszorg@ocmw.gent
🌐 www.stad.gent/ocmw
📘 Gent tegen armoede



INFO

Dienst Gezondheidszorg & Medische Kaart
Bezoekadres: Offerlaan 264, 9000 Gent
Postadres: Botermarkt 1, 9000 Gent
☎ 09 266 99 11
✉ onthaal.gezondheidszorg@ocmw.gent
🌐 www.stad.gent/ocmw
📘 Gent tegen armoede



gent:

MEDISCHE KAART GENT VOOR DRINGENDE MEDISCHE HULP

Informatie voor gebruikers

NL

AL